



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE / PËR PRANIMIN NË SHËRBIM CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**Lloji i diplomës “Inxhinieri Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë
Ekonomike/Inxhinieri Telekomunikacioni”**

niveli minimal i diplomës “Master”

Në zbatim të nenit 21, 22 dhe nenit 25 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurën për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë ekzekutive:

- 1 (një) Specialist në Sektorin Teknik, në Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave dhe Teknologjisë së Informacionit, kategoria III-b

Pozicioni më sipër, pozicioni u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbim civil për kategorinë ekzekutive.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LEVIZJE PARALELE: 25.10.2019

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 31.10.2019

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- a) Zbaton rregullat dhe procedurat për menaxhimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, si rrjetin kompjuterik, email-et, internetin, sistemin e serverëve, sistemin e backup-it, faqen e internetit etj.
- b) Harton apo paraqet propozime për përmirësimin e procedurave të nevojshme për mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe sistemeve elektronike të sigurisë fizike të institucionit.
- c) Siguron mirëmbajtjen e pajisjeve hardëare dhe softëare të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe sistemeve elektronike të sigurisë fizike të institucionit.
- d) Ndjek zgjidhjen e problematikave në lidhje me mosfunksionimin e faqes së internetit të AMA-s duke mbajtur komunikim me kompaninë përkatëse të hostimit.

- e) Ndjek zgjidhjen e problematikave në lidhje me mosfunksionimin e email-it zyrtar të AMA-s duke mbajtur komunikim me kompaninë përkatëse të hostimit.
- f) Ndjek zgjidhjen e problematikave të mosfunksionimit të sistemeve elektronike të sigurisë fizike të institucionit duke mbajtur komunikim me kompanitë që kryejnë mirëmbajtjen e tyre.
- g) Vlerëson vendimet, rekomandimet, udhëzimet dhe çdo akt tjetër të nxjerrë nga organizmat ndërkombëtar (ITU, ETSI, ISO, etj.) në lidhje me cilësinë e shërbimit dhe standardet teknike të rrjeteve dhe shërbimeve audio/audiovizive.
- h) Propozon hartimin e standardeve teknike të rrjeteve dhe shërbimeve audio/audiovizive mbështetur në vlerësimin e standardeve ndërkombëtare.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë mbi një vit eksperiencë në nivel ekzekutiv.
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” në “Inxhinieri Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Inxhinieri Telekomunikacioni”. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Aftësi shumë të mira teknike, komunikimi dhe prezantimi.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokoll – arkiv, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim
- b) Fotokopje të diplomës;
- c) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- d) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 25.10.2019.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Në datën 28.10.2019 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri mbi Direktiva, rekomandime, standarde ndërkombëtare të ITU, CEPT etj.
- Njohuri mbi ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për përvojën (20 pikë), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pikë), si dhe çertifikimi pozitiv (10 pikë). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës (legjislacionin përkatës);
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Për kandidatet që aplikojnë nga jashtë sistemit të shërbimit civil

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për plotësimin e vendit të lirë.

II.1-Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” në “Inxhinieri Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Inxhinieri Telekomunikacioni”. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Aftësi shumë të mira teknike, komunikimi dhe prezantimi.

II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrim
- b) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- dh) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- e) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi deri në datën 31.10.2019 në Autoritetin e Mediave Audiovizive.

II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Në datën 04.11.2019, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri mbi Direktiva, rekomandime, standarde ndërkombëtare të ITU, CEPT etj.
- Njohuri mbi ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

II.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

II.6- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Autoritetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë